



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Kuvendit Komunal Rahovec, mbajtur më 7 qershor 2011, me fillim në ora 10, në sallën e KK-së. Të pranishëm: këshilltarët (28), z.Smajl Latifi, kryetar i Komunës, z.Hazër Tara nënkryetar i Komunës, drejtorët e drejtorive, përfaqësuesit e OSBE-së, KDI-së dhe OJQ tjera dhe mediat.

Mbledhjen e ka kryesuar z.Kujtim Popaj, dhe nuk pati asnjë vërejtje në lidhje me dorëzimin e materialit për këtë mbledhje. Ai përshëndeti Zyrën e OSBE-së për pajisjen teknologjike që i ka dhuruar këtij Kuvendit, një laptop, një video projektor, një skaner dhe një pajisje tjetër, e cila pajisje do të shërbejë për një punë më efikase të Kuvendit të Komunës. Për mbledhjen e sotme kryesuesi ka propozuar këtë

REND DITE

1. **Aprovimi i procesverbaleve nga mbledhjet e 15.03. dhe 19.04.2011**
2. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba,**
3. **Shqyrtimi i kërkesës së KRM “Eko-regjioni” Prizren – Njësia në Rahovec dhe**
4. **Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve.**

Në pikën e 4 do t’ju informoj lidhur me vizitën që ka pas delegacioni i Komunës në Turqi si dhe kërkesën për zëvendësimin e një anëtari të Komisionit për ndarjen e bursave, në vend të z.Dervish Çadraku pjesëtar të ish Qeverisë.

Salih Hoti – është një çështje e cila është zhvilluar tinëzi ose prapa shpinës së institucioneve komunale të Rahovecit dhe ka të bëjë me Projektligjin për Hoqjen e Madhe e që është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës me Marrëveshjen ndërkombëtare edhe me pakon e Ahtisarit. Kuvendi i Komunës në bashkëpunim me institucionet tjera komunale duhet të dal me një qëndrim të përbashkët ose një konkluzion. Prandaj ju ftoj që ta fusim sot në rend të ditës dhe të debatojmë.

Avdullah Kryeziu – pajtohem me propozimin e Salihut, por pasi që ne nuk kemi këtë Projektligj dhe nuk jemi të njoftuar, do të ishte mirë që në seancën e ardhshme të njoftohemi në mënyrë më detale. Propozoj që pas pikës së aprovimit të procesverbalit të jetë pika pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve pasi që në fund të seancës interesimi po bie dhe shumica e delegatëve e as mediat nuk janë prezent.

Burim Krasniqi – afaristi Gëzim Shala nga fshati Xërxë, ka Fabrikën e letrës përmbi fshatin Apterushë. Ai ka në shfrytëzim pronën prej Komunës, mirëpo ka një projekt në Komisionin Evropian me një investim në vlerë prej 6.5 milion Euro për riciklimin e mbeturinave të letrës. Ky Komision kërkon që pronësia të jetë pronë e personit e jo pronë në shfrytëzim e Komunës. Ai ka pronën në Zatriq dhe është i interesuar që të bëjë kompensimin sipas shkallës së bonitetit të tokës në mënyrë që të ketë në pronë të vet. Kjo nuk ka kaluar në KPF, mirëpo ai ka afatet kohore të kufizuara dhe do të ishte mirë që të kalojë më shpejtë. Propozoj që të futet në rend të ditës .

Feim Fetoshi – natyrisht që është shqetësuese çështja e këtij Projektligji që qenka në përpunim e sipër për fshatin Hoqë e Madhe, ne jemi informuar nga mediat dhe konsiderojmë se është shqetësuese për ne si këshilltar e më tepër duhet të jetë shqetësuese për Qeverinë e Komunës së Rahovecit. Duhet të jemi të kujdesshëm që të mos bëjmë hapat e ngutshme për derisa ne nuk kemi asgjë përpara. Një Projektligj i tillë përgatitet në një nga ministritë e Republikës së Kosovës. Nuk guxojmë të bëjmë paralelizma qeverisje lokale – qeverisje qendrore.

Lidhur me iniciativën e z. Gëzim Shala shumë pak jam i informuar.

Shpesh herë njerëzit të cilët kanë mbrojtur edhe natyrën dhe jetën dhe pronën e njerëzve, ju është mvëshë një alibi që gjoja janë kundër zhvillimit lokal, tani kemi rastin që të dëshmojmë që jemi për zhvillim lokal, për një zhvillim të fortë ekonomik. Jo një initiative private, por është një projekt i Bashkësisë evropiane dhe është për mbrojtjen e ambientit dhe duhet të jemi të vetëdijshëm që këto të

jenë prioritet i prioriteteve dhe të tregojmë veten që tamam jemi për zhvillim ekonomik dhe jam pro iniciativës që kjo çështje e Gëzim Shalës të vendoset sot.

Lirih Berisha –Propozoj që të hidhet në votim ky projekt ligj dhe të deklarohemi kundër dhënies të statusit special të Hoçës sepse kjo është gjë shumë e keqe për Komunën tonë.

Nahit Elshani – sa i përket Ligjit jam i informuar vetëm nëpërmjet mediave, nuk mund të hyjmë dhe të debatojmë për diçka që nuk dimë çka është. Pajtohem me Feimin, nëse një Ligj ka ardhur prej Ministrisë, ne nuk mundemi sot të diskutojmë dhe të dalim në kundërshtim me organet qendrore. Na ofroni draft Ligjin, nëse është nevoja mbajmë edhe një mbledhje tjetër jashtë radhës dhe aty e diskutojmë. Më vjen mirë që tani ka njerëz këtu që janë pro zhvillimit ekonomik dhe pro ndërtimit të fabrikave. Dikujt po i ngutet si shumë, por mos të harmojmë se prona është çështje e ndjeshme, pa pas kurrfarë materiali sot nuk mund të lejojmë të bëjmë ndërrimin e pronave në Zatriq me pronën përmbi Hoçë të Madhe. Të na ofrohet kërkesa dhe të shohim se çka do të përfitojë zotëriu prej Komisionit evropian dhe është kusht prona dhe të marrim vendim, por ku do të bazohemi a është ajo kërkesë e Komisionit evropian. Ne nuk kemi kurrfarë materiali përpara e sot duam të marrim vendim. Për kërkesat të thirret mbledhje tjetër në bazë të atij materiali që na ofrohet prej Qeverisë komunale.

Sinan Ejupi –në lidhje me draft Ligjin në fjalë për Hoçën e Madhe edhe neve na shqetëson, mirëpo pa informatë të hollësishme dhe pa material nuk do të jetë e dobishme të bëjmë diskutime. Në lidhje me ndërrimin e pronës për z.Gëzim Shala, është një propozim shumë joshës, i mirë, mirëpo në këtë rast nuk kemi dokumentacion përkatës se cilat janë ato parcela dhe në çfarë proporcioni do të bëhet ndërrimi, prandaj duhet të përgatitet dokumentacioni dhe të kemi një bazë për diskutim, ne jemi pro çdo zhvillimi ekonomik.

Fane Thaçi – pajtohem me parafolësit rreth këtij Projektligji të Hoçës së Madhe dhe që jemi të brengosur. Në fakt ne ende nuk e dimë se çka përmban ky Projektligj, prandaj propozoj që materiali të sillet në seancën e ardhshme dhe të debatojmë këtë çështje.

Esad Haxhijaha –për Hoçë të Madhe për herë të parë po dëgjoj, nuk e di se çka fiton dhe çka humb Komuna. Nëse është çështja e një organizimi në nivel të Ministrisë për krijimin e kushteve më të mira të banorëve të fshatit në H. Madhe pse duhet të na pengoj ajo, përndryshe ndarjen e Hoçës së Madhe nga Komuna nuk mund të bëjë askush pa një referendum me qytetarë të Komunës së Rahovecit. Sa i përket çështjes së dytë që dikush me marr një parcelë si ndihmës e zhvillimit ekonomik, duhet të jepet me argumente, me fakte, me një ofertë serioze e cila mund të jetë bindëse për të gjithë ne. Prona, pasuria e komunës nuk mund të falet, as të shitet e as nuk mund të tjetërsohet, por mund të jepet në shfrytëzim për një afat për sa është e interesuar pala, nga kjo nuk e shoh të arsyeshme që ne të humbim kohë se a duhet të vihet apo jo në rend të ditës.

Fatmir Kadiri –kërkoj nga kryetari që të na shpjegojë më shumë për këtë draft Ligj shumë të rrezikshëm për Komunën tonë por edhe për Kosovën. Sa i përket kërkesës së Gëzim Shalës ai ka punuar në Gjakovë, ka pasur harxhime në transport dhe vështirësi në investim rreth përpunimit të letrës, ky Kuvend ia ka mundësuar të ndërtojë fabrikën në Opterushë, kurse tani këta kolegë nuk e përkrahin Gëzimin i cili tërë dokumentacionin ja ka ofruar kryesuesit por edhe kryetarit. Kërkoj prej jush që ta përkrahni këtë projekt që ka vlerën 6 milion Euro.

Smajl Latifi, kryetari i Komunës –para 20 ditësh jemi informuar për Projektligjin për Hoçën e Madhe. Ministria e Planifikimit Hapësinor bashkë me përfaqësuesit e Ministrisë së Pushtetit Lokal, përfaqësuesit e ICO, Zyrës ligjore etj. kanë bërë një punë të gjatë, të mundimshme për të hartuar një Projektligj që ka të bëjë ekskluzivisht vetëm për Hoçën e Madhe. Unë i falënderoj publikisht Asociacionit të Komunave të Kosovës, që e kanë bllokuar Ligjin dhe na kanë njoftuar zyrtarisht . Edhe AKK e ka kundërshtuar Projektligjin. Unë kam qenë pjesë e një takimi me Grupin punues që ka punuar për dy vite në hartimin e këtij Projektligji dhe e kam kundërshtuar në parim këtë Projektligj duke përdorur argumente, fakte relevante. Dikush tha që jemi njoftuar përmes mediave, të them të drejtën ne kemi sugjerim ose rekomandim që këto gjëra të mos bëhen fare publike, por unë i kam bërë publike sepse është shqetësuese dhe me rrezik për qytetarët e komunës dhe i kam njoftuar gazetarë dhe i kam sugjeruar një zyrtari të Komunës që t’ua dërgoj në e-mail adresat elektronike të gjithë anëtarëve të KK-së ku e keni ju nga dita e djeshme Projektligjin. Ju nuk keni pasur kohë për ta lexuar dhe analizuar, mirëpo ICO ka qenë në komunën e Rahovecit dhe po përpiqet të shpejtojë hapin. Si kryetar Komune jam definitivisht kundër këtij projektligji, presim që të vijë përfaqësuesit e

Ministrisë së planifikimit, të MPL, të ICO ne s' duhet të pajtohemi asnjëherë me ligjet të cilat e cenojnë interesin e qytetarëve të komunës, interesin e komunitetit serb që jeton në Hoçë të Madhe, që e cenojnë në mënyrë të drejtpërdrejt edhe dinjitetin e institucioneve të Komunës së Rahovecit. Shoqëria civile nuk e di kah e ka marr, por diku 13 OJQ e kanë kundërshtuar atë, ne nuk mund ti japim dritën jeshile një ligji i cili i ngjall armiqësitë e vjetra midis etnive në Komunën e Rahovecit dhe i jep fshatit Hoçë e Madhe të ketë Këshill legal, të ketë rregullore, të drejtë të bëjë plane rregullative, të kenë mandat si Ju anëtarë të Kuvendit komunal, një parim që nuk vlen për asnjë fshat në Kosovë dhe për asnjë fshat në Komunën e Rahovecit, të vlejë vetëm për Hoçën e Madhe. Ne jemi këtu për t'i ndihmuar për më shumë projekte investuese në Hoçë të Madhe, për më shumë zhvillim të saj, për më shumë mirëqenie të saj dhe në asnjë mënyrë nuk mund dhe nuk duhet të lejojmë që të bëhen kompromiset të cilat neve na sjellin në një situatë të vështirë. Nga Komuna e Rahovecit ka qenë i përfshirë Sllavisha Kollashinac i cili asnjëherë nuk më ka informuar dhe unë kam bërë shkëlqen e disa parimeve me ju informuar juve dhe jam i gatshëm të marr të gjitha përgjegjësi për shkak se ne duhet ruajtur, mbrojtur dhe përfaqësuar në mënyrë dinjitoze interesin e qytetarëve të Komunës së Rahovecit. Ne kemi sakrifikuar shumë në drejtim të integritetit, kultivimit të bashkëjetesës. Konsideroj se nuk ka nevojë që të ketë Ligj të tillë Hoça e Madhe, nuk ka të drejtë Këshilli i fshatit që të ketë rregullore të brendshme. Nuk duhet me u pajtu me projektet të cilat në start na sinjalizojnë që nuk kanë me qenë të mira, një fshat prej 500-600 banorë paska mundësi të sfidoj Komunën e i cili paska edhe grupe ekspertësh dhe nuk e di nga vijnë ata, ne nuk jemi të interesuar të zhvillojmë politikën e konfrontimit ndaj minoriteteve por politikën e integritetit të zhvillimit të projekteve të cilat i ndihmojnë edhe minoritetet e në këtë rast edhe minoritetin serb. Unë s' mbaj asnjë lloj përgjegjësie në qoftë se situata del jashtë kontrollit institucional. Ne do t'i drejtohem nesër me shkresë Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Zyrës ndërkombëtare civile, ICO, do t'i drejtohem kryetarit të Parlamentit, Komisionit parlamentar, Ministrisë për Planifikim Hapësinor, MAPL-së dhe do të adresojmë qartazi. Shefat e grupeve mund të marrin pjesë në ato takime dhe nuk do të jenë të mbyllura siç po kërkojnë ata dhe do t'i informojmë qytetarët për çështjet të tilla kaq të ndjeshme që kanë të bëjnë me Komunën tonë. Nëse Projektligji shkon në Kuvend të Kosovës, unë si kryetar i Komunës në Kuvendin e Kosovës dhe do t'i shprehi shqetësimet e Komunës së Rahovecit për sa i përket Projektligjit nga se ky Projektligj absolut nuk është i nevojshëm. Për sa i përket çështjes së dytë, dje ka ardhur kërkesa nga z.Gëzim Shala dhe nëse është lënda e kompletuar dhe mund t'i shërbejë ndaljes së këtij investimi shumë milionësh, atëherë jam për të diskutuar dhe ne ishim dakorduar nëse gjithçka është në rregull mund të shkohet edhe me procedurë të shpejtë.

Nahit Elshani – me planin e Ahtisarit, Hoça e Madhe është zonë e mbrojtur e trashëgimisë kulturore. Për atë që thatë ju si kryetar komune, unë plotësisht pajtohem që duhet me këmbëngul nëse vërtet është diçka që e cenon integritetin komunal të Rahovecit dhe nuk ka nevojë të dallohet Hoça e Madhe prej fshatrave tjera, nuk duhet me u ngutë me debat diçka pa na u ofruar draft Ligjin. Ndërsa te çështja e dytë, është çështje prone dhe nuk duhet të ngutemi, pa pasur dokumentacion të saktë se për çka bëhet fjalë këtu. Do të kemi shumë kërkesa tjera që do të kërkojnë të ndërrojnë pronën. Duhet të kemi kujdes. Askush nuk është kundër zhvillimit ekonomik por askush nuk duhet t'i lejoj vetes bajraktarllëk me i mbrojt njerëzit. Ne ja kemi dhënë atë për 10 vite dhe nëse ai afaron me sukses ne ja japim edhe për 40 vite, por jo me tjetërsua pronën. Duhet të kemi argumente se ai do të investoj 6 milion €.

Smajl Latifi – lutja e ICO është që nuk donë të bëjnë transparente, i frikohen reagimeve sepse edhe ata janë të bindur që kjo nuk është e mirë. Ne do ti njoftojmë edhe qytetarët e Komunës. Te çështja e dytë ne lëndën e kemi marr dje dhe është çështje e juaja se a do të shkon në mënyrë të përsheptuar apo ju duhet kohë që të analizoni dhe trajtoni më seriozisht këtë kërkesë. Ne projekt aktvendimin e kemi përpiluar por nuk është e thënë që e kemi bërë për sot.

Lumturije Hoti – kam vërejtje në dhënien e fjalës, dikujt i jepet menjëherë, dikujt jo. Ky projekt ligj është në kundërshtim me Kushtetutën dhe propozoj që nga ky Kuvend sot të dalim me një deklaratë dhe të njëjtën t'i dërgojmë AKK-së se ne nuk pajtohemi me këtë Projektligj dhe të marrim një vendim që e kundërshtojmë këtë ligj.

Kryesuesi – më e arsyeshme është që në fund të seancës kryetarët e grupeve parlamentare të mbledhemi dhe të dalim me një deklaratë ose të kërkojmë një seancë të jashtëzakonshme, mirëpo pasi që nuk kemi informacione për këtë Projektligj. Lidhur me pikën e dytë, Gëzim Shala i ka kërkuar të bëjmë transferimin e tokës, ka një sipërfaqe në Zatriq të cilën dëshiron t'i jep Komunës ndërsa të marrë parcelën të cilën e ka në shfrytëzim, të ndarë nga Kuvendi i komunës për 10 vite. Të gjithë jemi për zhvillim ekonomik, ti ndihmojmë bizneseve që bëjnë hapjen e vendeve të reja të punës, por konsideroj se vendimi mund të jetë i ngutshëm. Kjo çështje do të trajtohet së pari në KPF dhe nëse e shohim se është e arsyeshme për Komunën e Rahovecit, për biznesin, do të thërrasim një seancë shumë shpejtë. Prandaj propozoj që këto dy pika së pari të shqyrtohen në KPF dhe pastaj në seancën e KK-së. Është edhe një kërkesë e Avdullah Kryeziut që pika e 4 e rendit të ditës të kalojë si pikë e 2 e rendit të ditës pas aprovimit të procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara.

Kryesuesi ka hedhur në aprovim rendin e ditës për mbledhjen e sotme dhe ka konstatuar se njëzëri aprovohet rendi i ditës me propozimin e A.Kryeziut që pika e 4 të shqyrtohet si pikë e 2 e rendit të ditës.

1. Aprovimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datës 15.03. dhe 19.04.2011.

Nahit Elshani – në faqen 7 të procesverbalit të datës 15.03. “tha se i kemi përmirësuar” duhet të jetë “ju thatë”. Në faqen 9 “dhe Kuvendi komunal në mënyrë që këto dokumente të mos mbesin në arkivin e Komunës” duhet të jetë “të mos mbesin të tilla në arkivin e Komunës” dhe në faqen 12 “dhe të cilat të jenë vërtetim në shërbim” duhet të jetë “të jenë vërtetë në shërbim”. Me këtë vërejtje kryesuesi konstatoi se procesverbalet nga data 15.03 dhe 19.04.2011 aprovohen.

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve.

Musa Cena, drejtor i Drejtorisë për ekonomi dhe zhvillim – përgjigje në pyetjen e këshilltarit Avdullah Kryeziu që Ekzekutivi të bëjë rishqyrtimin e kontratave për Fabrikën e OLT-it dhe depot e Matrexit në Xërxë dhe të merret parasysh përgjegjësia e qiramarrësit. Detyra, afatin kontraktues dhe të njoftohet KK-ja lidhur me kontratat të cilat kanë qenë të dyshimta.

Është shqyrtuar kontrata e Fabrikës së OLT-it e shpallur me 2005-të, fitues i tenderit ka qenë Firma “Rafiii” nga Rahoveci, me sipërfaqen 1.506 m², atëherë shfrytëzimin e një pjese të Fabrikës së OLT-it e kishte Morgu deri në vitin 2007. Çmimi për m² ka qenë 82 cent i cili është reviduar me kërkesë nga shfrytëzuesi i atij tenderi dhe me vendim të Kuvendit komunal janë revidu kushtet në veçanti çmimi shfrytëzuesi i asaj kontrate dhe asaj hapësire tani është 0.12 cent për m², pra kemi të bëjmë me lejet e Kuvendit komunal që ka lejuar ndryshimin e këtyre kushteve. Kushti i parë është bërë me vendim të Kuvendit më 15.07.2006 dhe ka qenë i vlefshëm deri më 31.12.2006 për një periudhë 6-të mujore. Me këtë vendim janë njoftuar të gjitha institucionet relevante zbatuese dhe ka hyrë në fuqi menjëherë. Me skadimin e mandatit të këtij vendimi vjen vendimi i dytë i datës 16.04.2007 i cili lejon vazhdimin e kontratës në mes të Kuvendit komunal dhe Firmës “Rafii” nga Rahoveci si shfrytëzues i këtij objekti me çmimet e aprovuara me datën që e përmenda më parë dhe e njëjta vazhdon deri më sot. Me marrjen e detyrës të drejtorit të Drejtorisë për ekonomi, kemi parë që pjesa e Murgut ka qenë e pa përfshirë dhe e pashfrytëzuar. Kemi ndërmarr hapa që edhe ajo pjesë të hyjë në funksion ose shfrytëzim. Sipas kontratës në pikën 10-të neve na obligon që si ofertë të parë t'i bëjmë Firmës shfrytëzuese “Rafii” por me kushtet fillestare e jo me kushtet e lejuara nga Kuvendi meqë kjo sipërfaqe atëherë nuk ka qenë e përfshirë në kontratën që është në fuqi dhe jemi në situatën që po presim përgjigje nga Firma shfrytëzuese “Rafii”. Afatin e ka deri në fund të kësaj jave dhe nëse ai nuk shpreh interes me marr pjesën e Murgut, ne do ta shpallim si shprehje e interesit, atë hapësirë do të japim në shfrytëzim me anë të tenderit. Objektet tjera që Komuna i jep në shfrytëzim me anë të shprehjeve të interesit është Matrexi në Xërxë ku për momentin i kemi 3 shfrytëzues të cilët po ashtu janë përdoruar me tender dhe fitues i atij tenderi ka qenë i shpallur për një sipërfaqe më të madhe bëhet fjalë për Firmën “Migros” nga Shtimja. Kaluan dy vite e ai vetëm një herë i është përgjigjur ftesës, i ka marr obligime dhe tani nuk jep kurrfarë informata. Arsyetimet e tija kanë qenë që Komuna nuk ka qenë në gjendje që t'ia liroj objektet që i ka fituar ai me tender me i futë në zbatim të projekteve të veta. Mirëpo, të njëjtat hapësira ai vetë i ka dhënë në shfrytëzim me qira firmave tjera.

Firma e Agrocelinës aty zhvillon një aktivitet në bazë të qiramarrjes që dmth. se është shkelje e kushteve që ka tenderuar firma në fjalë. Pas tentimeve tona ai vjen më datën 16 prill, zhvillon një bisedë me mua, i kërkoj qëndrimet e tij se çka ndërmend ai të bëjë më tutje me këtë kontratë, ai obligohet në Komunë me një qira në vlerë prej 52.000 €. Ai prapë kërkon që t'i lirojmë ne atë sipërfaqe për të zbatuar ai projektin e tij. I kemi dhënë një javë afat me dhënë variantin e vetë të shfrytëzimit të atij objekti me shkrim. Ai nuk paraqitet fare në ftesat e mia për mos shfrytëzim, nuk përgjigjet fare. Jam detyruar ta thërras me telefon ai prapë nuk përgjigjet dhe e bëjë një shkresë njoftimi Zyrës së prokurimit meqë ata janë nënshkrues dhe përgjegjës për zbatimin e asaj kontrate të nënshkruar, i dërgojmë njoftim për ndërprerjen e asaj kontrate, ndërsa procedura do të vazhdon në organet gjyqësore. Shfrytëzues tjetër në sipërfaqet e OLT-it është Firma "Frigostar", ka një kontratë të rregullt e cila është në fuqi dhe me pagesa është diçka prapa, por prapë se prapë në bazë të mundësive të veta i kryen obligimet. Firmat Matrex dhe Xeni-commerce e Fortesës e shfrytëzojnë një lamelë në pjesën e Matrexit, është një firmë e mirë, bënë pagesat në mënyrë të rregullt dhe nuk kemi asnjë problem me sipërfaqet që i menaxhon ajo. Tani jemi në diskutim si Qeveri për hapat e më tutjeshme për sipërfaqet e pa shfrytëzuara.

Smajl Latifi – kontrata ju ka ndërprerë atij me vendim dhe duhet t'ua bëjmë me dije se në atë hapësirë ku ka qenë në shfrytëzim ai pronar, aty tani është duke u zhvilluar aktiviteti për vendosjen e stabilimenteve të pikës grumbulluese. Është projekti i BE – Komisioni evropian ku ne si komunë jemi partner dhe kemi dashtë me qenë më afër rrugës. Ai nuk u paraqit, lënda është në Gjykatë në procedurë, ai është i obliguar që t'i paguaj 53.000 €, ne mund t'i japim mundësi, por tani kontrata i është ndërprerë.

Feim Fetoshi - u përmend çmimi i ulët në Matrex do të thotë tre apo katër fish më i lartë, pse është kjo dhe a mund të ndryshojë sepse nuk është reale.

Musa Cena –për ndryshimin e çmimit ka vendos Kuvendi komunal me një vendim të përkohshëm herën e parë dhe ë pastaj me një vendim të përhershëm deri sa zgjatë kontrata dhe është nga 92 në 12 cent që do të thotë për pesë herë dhe kjo është nga 12 prilli 2007, është vazhdimi i lehtësimit të parë që i është dhënë shfrytëzuesit dhe ka mbetur në fuqi deri në skadimin e kontratës e cila skadon në vitin 2013.

Nahit Elshani – ju e thatë që ka pasur një ndërprerje të kontratës ndërsa unë e di që "Raffi"-it nuk ju ka ndërprerë asnjëherë kontrata. Një kërkesë e "Raffi"-it dhe kompanisë AE Holding që ka pasur Matrexin, kanë qenë për me i zbritë qiranë në muajin korrik dhe i është zbritur deri në fund të vitit por me kusht që ata në fillim të vitit të vijnë dhe të negociojnë a dojnë të vazhdojnë kontratën me çmimet të cilat i kanë pasur në bazë të tenderit që kanë ofruar vetë dhe nëse jo atëherë kontratat i ndërpriten. Në janar çmimi OLT ka qenë dashtë me qenë në 82 cent e jo të vazhdoj me 12 cent, kërkesa ka qenë vetëm për një periudhë kohore. Shikoni mirë sepse nuk keni të bëni me vendim i cili është i përhershëm me 12 cent.

Musa Cena – në vendimin e parë është deri më 31.12.2006, mirëpo me vendimin e dytë apo plotësimin e vendimit ka të bëjë prej 1 janarit 2007 e deri në përfundim siç e ceka më parë.

Esad Haxhijaha – çështja e lokaleve për rezerva shtetërore në Xërxe dhe OLT-it është çështje e - Asamblesë në përbërjen e mëparshme e jo të Asamblesë së tanishme. Nuk është Musa i cili mund të jep përgjigje se sa ne që jemi marr me këto punë. Është e vërtetë që të dy këto objekte janë dhënë me tender. Ata që kanë ofruar kushte më të mira ata e kanë marr. Lokalet në Xërxe i ka marr AEE Holding, kanë qenë përfaqësues të bankës private së bashku me një punëtor tonë dhe një kohë ka funksionuar mirë. Përveç këtyre një pjesë e ka shfrytëzuar edhe "Anadrinia" Ndërmarrja bujqësore dhe më vonë firma e Sinanit, mirëpo me kohë çështjet janë çrregulluar. Ka ardhur Kompania AEE që ndërpres veprimtarinë e më tutjeshme ose me kusht që mundësisht ti zvogëlojmë çmimin e qirasë dhe atë për një kohë të shkurtër deri kah fundi i vitit 2006, për ndryshe më vonë ajo firmë është tërhequr dhe është mbyll veprimtaria e asaj firme. Të njëjtën gjë ka bërë edhe OLT-i. Asambleja ka zbritur qiranë për të dyja firma deri në fund të vitit 2006 ndërsa për viti 2007 është dashtë të bisedohet nëse janë të interesuar për më tutje të shfrytëzojnë këto objekte. Nuk është shfrytëzuar asnjëherë dhe nuk është realizuar projekti në tender për funksionimin e kësaj ndërmarrje sepse është dashtë të punësohet numri prej 50-60 punëtorëve mirëpo, kjo nuk është realizuar dhe sot po parashtroj pyetjen se si ka llogari të paguaj atë qira. Në momentin kur fituesi i tenderin nuk e zbaton kontratën në atë moment i

ndërpritet kontrata. Tani organet komunale mund të anulojnë kontratën dhe të bëhet zgjidhja tjetër. Rreth lokaleve të Murgut, atëherë ai ka qenë i shfrytëzuar prej organizatës e cila është marr me kufoma dhe në vitin 2006 është tërhequr. Murgu ka mbetur i zbrazët. Kanë qenë biseda që ajo pjesë e Murgut t'i jepet shfrytëzuesit "Rafii" dhe është marr një vendim i tillë, por nuk është realizuar asnjëherë sepse, komisioni i cili është formuar që të bëjë vlerësimin, regjistrimin e mjeteve në murg nuk e ka kryer punën asnjëherë dhe ajo pjesë ka mbetur pa u shfrytëzuar. Tani lokalet e rezervave shtetërore janë të lira dhe se janë biseda me Elkosin rreth hapjes të një pike të grumbullimit të pemëve dhe perimeve dhe të gjitha prodhimeve bujqësore në Kosovë dhe kjo është një zgjidhje e mirë, por Kuvendi komunal nuk duhet t'i lejë objektet e pa shfrytëzuara për të mos humbur qiranë.

Avdullah Kryeziu – këto pyetje nuk janë me qëllime të caktuara, mirëpo nuk kemi pasur raportin e auditorit të jashtëm në vitin 2008 dhe 2009. Te Matrexi kontrata ka qëndru një çmim shumë i lartë i mos pagesës së kontratës, vlera ka qenë diku mbi 100.000 €. Konsideroj që është një papërgjegjësi edhe e organeve komunale, jo të juaja z. kryetar sepse ju nuk keni qenë atëherë por edhe të përfaqësuesve të cilët kanë marr këto kontrata dhe nuk i kanë kryer obligimet e veta. Konsideroj që çmimi 82 cent në 12 cent është shumë joreal për atë kohë dhe kam kërkuar që të bëhet korrigjimi. Nëse ka pasur vendim që ky çmim të jetë deri në fund të kontratës krejt në rregull, unë nuk kam qenë përfaqësues i Qeverisë dhe e di shumë mirë që ky çmim ka qenë i përcaktuar nga Kuvendi deri në fund të vitit 2006 ndërsa në vitin 2007 kontraktuesit kanë pasur për obligim ta paguajnë çmimin fillestar ose të shpallet tender për Matrexin dhe për Olt-in.

Përparim Krasniqi, drejtor i Drejtorisë për shërbime publike komunale dhe emergjencë - pyetjes së këshilltarit A. Kryeziu për ujin në fshatin Retijë. Në qoftë se kemi mundësi me rishikim buxhetor atëherë do të vendosim edhe rezervuarin. Përgjigje për këshilltarë nga Fortesa: për lumin Rimnik ne kemi krijuar një komision, pritet që komisioni të del me një vlerësim për këtë lum, janë pre punimet do të bijmë vërejtjet e komisionit dhe të shohim më tutje. Lidhur me pyetjet e L.Berisha për tualetin në Shkollën fillore në Drenoc. Ne kemi shpallur tenderin për kanalizim në fshatin Drenoc dhe si të fillojnë punimet e kanalizimit do të lidhet edhe tualeti i shkollës.

Elhami Zhuniqi – kam bërë pyetjen se çfarë do të ndërmerret për hapjen e kanalit të kullimit të ujërave atmosferik mes fshatit Fortesë dhe Xërxe me një sipërfaqe rreth 100 ha të cilat janë nën ujë në pjesën më të madhe të kohës. Punimet janë filluar para 3 viteve. Pse janë ndërprerë punimet, a do të vazhdohet dhe çka do të bëhet më tutje.

Përparim Krasniqi – me rishikim të Buxhetit do të shohim mundësinë të rregullojmë atë kanal dhe të intervenojmë, përndryshe nuk ka mjete dhe nuk kanë mundur të vazhdoen punimet.

Feim Fetoshi – a është krijuar ky komision për me vlerësuar punën që është bërë deri tani apo për problemet që ka lumi Rimnik, sepse janë dy gjëra të ndryshme.

Përparim Kraniqi – ne i kemi ndërprerë punimet, kemi formuar komisionin për vlerësimin më të mirë të situatës sepse siç shihet ai projekt nuk ka qenë i detajizuar mirë sepse lumi është ngritë ndërsa lumi duhet të hapet, prandaj kemi qenë të detyruar të formojmë komisionin dhe të analizojmë më tutje se çka mund të bëjmë.

Feim Fetoshi – ju keni formuar një komision për të analizuar problematikën e këtij lumi e jo punën që është bërë deri tani, atëherë unë kërkoj nga ju me më tregu se kush janë anëtarë të komisionit sepse për të analizuar atë punë duhet të jenë njerëz shumë profesionistë, që kanë përvojë, kanë referenca, sepse ne që jetojmë në Fortesë e dimë që nuk është çështje bash e lehtë.

Përparim Kraniqi – në këtë komision janë të përfshirë inxhinierët e Komunës nga Drejtoria për urbanizëm dhe ata do të bëjmë vlerësimin.

Feim Fetoshi – që dy herë po hudhen mjetet në këtë lumë kot. Është kërkesë e fshatit Fortesë që për analistë të kësaj problematike duhet të angazhoni një firmë që është profesioniste për këtë çështje, sepse me gjithë respektin për inxhinierët, kjo çështje i tejkalon mundësitë e tyre.

Smajl Latifi – pres raportin përfundimtar të këtij Komisioni, janë prerë punimet sepse në këto rrethana, shkojnë mjetet dem dhe asgjë nuk do të bëhet. Anëtarët e komisionit janë inxhinierë që kanë punuar me përkushtim dhe kanë me analizuar deri në fund situatën deri te një konkluzion i qartë se çka do të veprohet më tutje. Sa është projekti i realizueshëm, ai që në fakt e kemi si projekt apo është projekt i parealizueshëm. Nuk paragjykoj, presim raportin dhe shpresoj që do të keni informatën e plotë.

Përparim Krasniqi – në lidhje me pyetjen e znj. Fane Thaçi për ujin e pijes për pesë fshatra po ju informoj se punimet në fshatin Çifllak kanë përfunduar për ujësjellës në fazën e dytë dhe tani do të fillojnë në fshatin Dabidol. Ne jemi në kontakt edhe me kryetarin e Gjakovës se në fshatin Bec kanë ngecë punët për shkak të problemeve pronësore juridike diku 800 m, besoj se edhe aty shumë shpejtë do të bëjmë një zgjidhje dhe shpresojmë që ky projekt të përfundoj sivjet. Sa i përket trotuareve do të planifikojmë në vitin 2012. Kanalizimi në lagjen e Sali Ramëve, ne nuk kemi marr kërkesë prej tyre por edhe këtë mund të planifikojmë për vitin e ardhshëm.

Lumturije Hoti – në projekt është lagja e Nallajve dhe Gashëve në Krushë, a do të filloj ky projekt në këtë vit.

Përparim Krasniqi – shpallja ka përfunduar, vlerësimi do të bëhet edhe 2-3 ditë do të fillojmë me punimet shumë shpejtë.

Ilirjana Gashi – kam një pyetje për drejtorin dhe për kryetarin e Komunës: pasi që rrjeti elektrik në fshatin Sapniq edhe në qeverisjen e kaluar por edhe tani, janë matjet dy herë ku po ngec ky projekt edhe pse e dimë që prej Gjakovës e ka sinjalin që të vazhdojë projekti, pse po zvarritet kaq shumë.

Përparim Krasniqi – puna nuk ka ngec por është e paraparë në muajin korrik.

Mirjeta Morina - pyes drejtorin në lidhje me fazën e dytë të rregullimit të ujësjellësit, cilat fshatra do të lidhen me ujësjellësin, kur do të fillojnë punimet dhe kur do të përfundojë për fshatrat Pastasel dhe Rudinë.

Përparim Krasniqi – fshati Çifllak, Dabidol, Kramovik, Guri i Kuq dhe Palluzhë. Punimet janë duke u zhvilluar në Dabidol, prej aty do të rrjedh dhe do të lidhet fshati Guri i Kuq dhe në fund do të përfundojë në Polluzhë. Ujësjellësi për fshatin Pastasel dhe Senoc është planifikuar për viti 2012 si projekt dhe shpresojmë që do të miratohet edhe nga Kuvendi dhe do të shohim më tutje, sepse për këtë vit nuk ka mjete buxhetore.

Sinan Ejupi - pasi që jam në Matrex si Frigostar dhe e kuptoj dhe e njoh shumë mirë problematikën se si ka ndodhë, si ka shkuar tenderi për OLT-in, ka qenë një ofertë joshëse e tenderuesit të atëhershëm “Rafii” shumë e mirë në projekt, mirëpo sa ka filluar ka ngecë edhe nuk ka pasur sukses. Edhe në Qeverinë e kaluar kam pasur vërejtje. Logjika e zhvillimit të komunës respektivisht të dhënies së pronave në këtë rast të objekteve komunale me qira ka qenë një logjikë jo e shëndoshë. Këtu shpesh është luajtur me çmimet e larta në fillim vetëm për të marr një sipërfaqe, një interes për të realizuar e pastaj me ekzibicione të ndryshme është bërë zbritja e çmimeve. Po e marrim një shembull: OLT-i është marr 80 cent. Unë kam qenë ithtar se 80 cent për sipërfaqe ka qenë shumë për një prodhues. Nuk mund të zhvillojmë Komunën nëpërmjet qirasë. Nëse i shikojmë vendimet e këtij Kuvendi të përbërjes paraprake prej 80 centi bijmë në 12 cent e sot në Matrex unë e kam 12 cent livadhin të cilit 50 € i vlen bari i tij. Unë jam për atë që Komuna e Rahovecit pa marr parasysh a janë objektet apo sipërfaqet të cilat janë në shfrytëzim, të shikoj se çfarë programi ofron zotëria. Problemi më i madh është se njerëzit konkurrojnë në çdo tender dhe lidhet për çmim e jo për program e Komunës i ka interesuar sa cent jep zotëria, nëse i ka dhënë 2 cent më shumë ai me një program që do të punësojë një 50 punëtorë me makina dhe teknologji të vjetër në fund, ka përfunduar si depo. Kërkoj që në të ardhmen Komuna e Rahovecit të ndjek një politikë të shëndoshë dhe të qartë, nuk është tragjedi e madhe që “Rafii” e paska për 12 cent, por tragjedia është se ai nuk e zbaton atë program ndërsa çdo tenderues lidhet në program e jo vetëm për pagesa. Kërkoj që këto politikat e dhënies me qira ose faljes si Gëzim Shala për 10 ose 50 vjet me çmime simbolike e që duhet me pas, të ndiqet strategjia e zhvillimit të komunës nëpërmjet programeve më komplekse, t’i jepen përparësi prodhuesve me prodhimet e veta më komplekse.

Fatmir Kadiri – e përkrahi plotësisht mendimin e Sinanit për punën e OLT-it. Kuvendi i mëparshëm ka bërë një papërgjegjësi shumë të madhe, ka dhënë një fabrikë me 12 cent, ndërsa për Matrexin njerëzit që veprojnë aty i shkelin, e merr lokalin me qira prej firmës tjetër që ka fituar tenderin me dallavere. Kryetari duhet të merret më shumë me çështje të Matrexit, se njerëzit që janë duke kryer veprimtarinë e vet me program të mirë, që janë duke punuar aty, e kanë me qira herë prej Sillosit, herë prej AEE, herë prej Mustafës dhe nuk vjen në pyetje të fitoj tenderin edhe pse punon dhe paguan kontributet në mënyrë të rregullt, puna e OLT-it kisha kërkuar që të formohet një komision, me analizua mjetet themelore se a janë të regjistruara dhe çka është bërë me ato sepse OLT-i ka qenë një Fabrikë shumë rentabile.

Sinan Ejupi –duhet të koncentrohemi më tepër në program se sa cent jep. Ne kemi rastin me një prodhim me produkte metalike i cili është në Matrex që gjatë tenderimit vetëm për një cent të oborrit Qeveria e kaluar nuk i ka dhënë atij, këta janë njerëz tanë dhe të cilët i kontribuojnë zhvillimit të Komunës, është mirë që të sistemohen.

Kryesuesi –ne si Kuvend e kemi trashëguar këtë pasuri komunale. Nuk kemi pasur rrugëdalje tjetër përveç që këto objekte ti japim në shfrytëzim me tender, çdo formë tjetër kishte me qenë jo transparente dhe jo e barabartë me operuesit, ai operator i cili vërtetë i plotëson kushtet më së miri ose paguan më shtrenjtë t'i jepet atij. Lidhur me borxhin pse ata nuk e kanë paguar Komunës është krejt një problem tjetër. Qeveria ka qenë dashtë edhe në atë kohë edhe tani me marr masa ndaj atyre operatorëve. Duhet t'i caktohen afatet kohore deri kur paguhet dhe nëse i zbaton e merr tenderin.

Fatmir Kadiri – personi i cili ka aty, fabrikën për përpunimin e metaleve, punëtorët e Komunës para dy muaj, i kanë thënë shko dhe lëshoje këtë vend këtu.

Musa Cena – unë e kam kontaktuar Zijajdinin vetëm në cilësinë e uzurpatorit në atë rast ndërsa ju tani po kërkonin informatat prej vitit 2000 dhe këto pyetje ju keni mundur shumë më herët me i shqyrtuar.

Feim Fetoshi – nga kjo që dëgjova nga protagonistët e asaj kohe kryetari E.Haxhijaha dhe z.Nahit Elshani lidhur me çështjen se si është bërë ai tender, kur kryetari e tha qartë se kusht ka qenë punësimi ndërsa nga Nahit nëse e kuptova mirë tha që nuk ka qenë vendimi ashtu si e interpretoi Musa Cena, unë kërkoj që Qeveria komunale ta shqyrtoj këtë çështje dhe në mbledhje tjetër të raportoj se si është e vërteta lidhur me këtë rast.

Nahit Elshani – pajtohem plotësisht që çmimi nuk duhet me qenë kriter bazë kur jepen me qira, mirëpo ka qenë atëherë dhe kur njeriu konkurren, nuk konkurren vetëm me çmim por ka edhe kushte tjera si punësimi dhe programi në përgjithësi. Çdo njeri që nuk ju ka përmbajtur programit, kërkoj që t'ju ndërpriten kontratat. Nëse ka ofruar 50 punëtorë e nuk e ka marr asnjë, nëse ai ka ofruar një program prodhues e nuk ka filluar me prodhu, duhet t'i ndërpritet kontrata dhe të shpallet tenderi. Komuna nuk duhet të bazohet në qira, nuk janë asgjë 50.000 € nga qiraja për Komunën, sa janë 50 punëtorë të punësuar me një objekt. Pyetjet që kam bërë në mbledhjen e kaluar për çështjen e lokalit i cili është i rrethuar me gardhin. Është një njoftim i inspektorit i cili e ka pa dhe ka konstatuar se zotëriu ka bërë uzurpim dhe ju ka drejtuar Drejtorisë së kadastrit për informata. Lejen ndërtimore këtij zotëriu ja ka dhënë me 05.04. Drejtorja për urbanizëm dhe planifikim hapësinor ndërsa kadastrit me 14.04. ka konstatuar se këtu kemi të bëjmë me uzurpim arbitrar të ngastrës 131.8, me kulturë ndërtësë dhe oborr, shfrytëzues Drejtorja komunale për kulturë në Rahovec ndërsa uzurpuesi është Ismet Cana nga Rahoveci. Si mundet Drejtorja për urbanizëm të jep leje me 5.04. ndërsa Drejtorja e kadastrit më 14.04. e ka njoftuar këtë zotëri që ka uzurpim arbitrar. Pyetja ka qenë atë ditë si është e mundur në qytet të lejohet të ndërtohet një gardh si dhe të vendoset koshi e gjëra tjera.

Smajl Latifi – Nga Drejtorja e kulturës është nxjerr një dokument tjetër i cili është konstatuar që kjo pronë ka qenë e Drejtorisë për kulturë. Ne sapo e kemi marr dokumentin Drejtorja për gjeodezi, kadastrë dhe pronë e ka analizuar lëndën. Në një periudhë dhjetëditore kanë ndodhë dy veprime të ndryshme kontradiktore.

Ne do të mbetemi luftëtarë të denjë që t'i kthehet Komunës ajo pronë që në fakt ka qenë pronë e saj. Pretendimet e AKP janë të qarta, anë lëshuar një kontratë detajet e së cilës nuk i dimë deri në fund, por mund të them se këto ditë lënda do të ekzekutohet. Detyrimisht pronari i atij lokali duhet të vijë patjetër në Komunë për të biseduar me përfaqësuesit e Komunës sepse ne e kemi gati lëndën për ekzekutim. Është dashtë të presim 30 ditë sipas procedurës ligjore. Jemi të interesuar me e rikthyer pronën sepse ajo është pronë e Komunës dhe duhet t'i mbetet asaj për nevojat e infrastrukturës. Pra është një kontest midis AKP-së dhe Komunës së Rahovecit i cili kontest do të sqarohet në ditët e ardhshme ndërsa për gardhin tani ka arritur lënda për ekzekutim, pra nuk vlen vendimi i parë ose leja por vlen vendimi i Drejtorisë për gjeodezi, kadastrë dhe pronë.

Nahit Elshani –unë jam skeptik se mund ta ktheni, e vetmja mënyrë që mund t'i ktheni Komunës që ky Kuvend të merr vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm për atë parcelë për ndërtimin e Shtëpisë së kulturës që qytetarë të mos kenë mundësi me ble se e dinë që është interesi i përgjithshëm

i Komunës për ndërtimin e një objekti të caktuar, përndryshe ajo shitet. Është shqetësim se këtu nuk ka komunikim të mirë në mes të drejtorëve.

Smajl Latifi – sa i përket komunikimit është mungesë e informacioneve të mjaftueshme dhe nuk është pasojë e një mos komunikimi si po e interpreton në këtë rast ti. Veprimet e tilla mund të ndodhin mirëpo e rëndësishme është që Qeveria Komunale e Rahovecit është e gatshme që në qoftë se bënë një shkarje ose ndonjë lëshim, që vjen qoftë edhe si pasojë e mungesës së një informate, sepse thash Drejtoria e urbanizmit siç e dini ju ka përgjegjësi tjera ndërsa Drejtoria e kadastrës i ka përgjegjësi tjera.

Esad Haxhijaha – pas gjithë kësaj i cili po ndodh para syve tanë qëndron një prapavijë e përfitimit, kush është tash përfitues këtu, nuk është vetëm Ismet Cana por edhe dikush tjetër qëndron prapa kësaj dhe unë po them nuk mundet AKP-ja me qenë pronare e diçkahit që nuk është pronar, kjo është pronë e Komunës. drejtori i kadastrës nuk jep leje por urbanizmi. Nuk ka punëtorë në urbanizëm i cili nuk din që kjo pronë është e Komunës. Nuk ka inspektor në Komunën e Rahovecit që nuk din që kjo është pronë e Komunës dhe si ka mundur ai të filloj së pari të punoj, është enigmatike do të thotë sipas logjikës qëndron një gatishmëri e disponimit të tolerancës dhe lejimi i uzurpimit para syve të gjithë qytetarëve. Nuk duhet të tentojmë këtë pronë t’ia kthejmë Komunës por të tentojmë të ndalim uzurpatorin sepse kjo është pronë e Komunës dhe çka kemi t’i kthejmë Komunës kur ajo është e Komunës. Aty ka qenë e paraparë të ndërtohet Shtëpia e kulturës, është hequr dorë se bëhet një sallë, por është e paraparë të bëhet një qendër tregtare sipas projekteve të përbërjes së mëparshme, dhe mund të bëhet një qendër tregtare fenomenale, por duhet normal të ecet me kohën e jo të lejojmë që dikush të na bëjë përrallë para qytetarëve të Komunës së Rahovecit.

Smajl Latifi – nuk thashë që nuk është pronë e Komunës, por po flasim në bazë të letrave që kemi. Ai ka një kontratë, një dokument prej AKP-së ndërsa ne kemi dokument që është pronë e Komunës. Kjo është luftë. Ne shpresojmë që luftën do ta fitojmë. Shumë shpejtë ju do të shihni rezultatet sepse aktvendimin që ka marr Komuna e Rahovecit në lidhje me këtë pronë po i skadon afati. Dy rrugë janë, ose kanë me shkuar në gjykatë ose inspektorati bashkë me autoritetet e Komunës kanë me marr masa konkrete dhe ju keni me pa rezultate. Nuk do të paragjykoj veç tash jemi në proces të realizimit të aktvendimit të Kuvendit të komunal. A do të realizohet përmes gjykatës apo inspektoratit ose në marrëveshje me AKP-në, me I. Canën, nuk e di, por ne do të duhej patjetër sipas Ligjit të veprimjës.

Xhemali Haxhimustafa – kemi pasur kohë nga viti 1999 të bëjmë evidentimin e pronës komunale, kjo nuk është bërë dhe dokumentet janë ashtu siç e thatë ju, kam punuar në ish BVI-në e kulturës dhe aty është vendimi për eksproprijimin dhe arondimin e tokave që njerëzve u janë paguar. Shembull Mesud Shehu e ka dyqanin aty për shkak se i është marr poshtë për të ndërtuar Qendrën kulturore dhe ish NBI-ja i ka dhënë komunës atë pjesë sepse ka qenë Njësi e ndarë dhe këtu qëndron problemi. A mundeni me marr atë tokë apo jo, duhet të bëhet evidentimi i pronës që kjo të jetë pronë komunale edhe pse është e regjistruar në librat kadastral, por meqenëse janë dhënë shënimet e gabuara KPA-së tani është një kontest gjyqësor. Është interesi Komunës sepse ai vend është pronë komunale do të shërbejë për diçka madhore për arsye se janë dhënë mjete financiare dhe njerëzit janë kompensuar e dikur ajo ndërtesë që është sot ka qenë Kooperativë bujqësore e Komunës së Rahovecit, ekzistojnë dokumentet dhe njerëz e dinë shumë mirë.

Musa Cena – z.Feim unë nuk mund të prejudioj gjëra, këto janë vendimet e KK-së të cilat i respektoj plotësisht e nëse ju keni diçka më tepër që unë nuk e di, parashtroni pyetje dhe tregoni periudhën kohore. Ne kemi Ligjin mbi prokurimin dhe doemos duhet të respektojmë në këso raste, sepse asnjë projekt që ka shkuar me këto marrje të koncesioneve ka qenë i pasuksesshëm dhe ka rrjedhë problematika.

Besa Hoxha-Beqiri, drejtoreshë e Drejtorisë për arsim – në pyetjet e parashtruara në seancën e kaluar për DKA-në nga z.Lirih Berisha, për kanalizim dhe tualet në Sh.F. “V.Frashëri” në Drenoc.

Gypat që duhet të vendosen në të DKA-së marrim përsipër dhe kjo do të kryhet nga ana e jonë posa të shpallim tenderin për renovim të shkollave. Për renovim të shkollave në Komunë tonë për këtë vit janë aprovuar 50.000 € ndërkaq i kemi edhe 5.400 € të bartura nga viti i kaluar. Shuma totale prej 55.400 € shumë e pamjaftueshme për t’i mbuluar nevojat e shumta që i kemi në shkollat tona. Fatmirësisht nga DKA është fituar një donacion i Zyrës ndërlidhëse të Komisionit evropian në vlerë prej 220.000 €,

prej të cilave 70.000 € janë për nxehe qendrore në SH.F. “Isa Boletini” në Rahovec, projekt kapital i cili ka qenë i aprovuar nga Ju vitin e kaluar dhe 150.000 € prej shumës totale prej 165.000 € sa do të kushton Shkolla në Gur të Kuq. Me rishikimin e buxhetit shpresoj që do të jemi në gjendje që këtë shumë të investojmë dhe të kyçim në shkolla aty ku me të vërtet kemi nevojë, për shkak edhe siç është cekë nga z.L.Berisha në Shkollën e Dejnës kemi kornizën e xhamave e cila i rrezikon nxënës. Problem me instalimin elektrik në Shkollën “Liria” në Fortesë dhe në shumë shkolla tjera kemi probleme me kanalizimet. Me vetë fitimin e këtij donacioni do t’i investojmë këto të holla aty ku është më se e nevojshme dhe të mënjanojmë rreziqet.

Lirih Berisha – është një absurditet shumë i madh dhe një përgjegjësi e madhe, kur ndërtohet tualeti fitohet tenderi, paguhet puna, nuk lidhet uji dhe nuk bëhet kanalizimi për daljen e ujërave të zeza jashtë. WC-ja është marruar në fillim të vitit, është mbyll me çelës, njeriu që e ka marruar i ka marr paret dhe nuk ka parë që 5 metra për të lidh ujin edhe 10 m kanalizim për ato. Besoj që do të rregulloni këtë gjatë pushimit që vjen.

Besa Hoxha-Beqiri – Fatkeqësisht ka pasur shumë mosplotësime të kontratave nga kontraktuesit që kanë pasur rregullimin e shkollave vitin e kaluar dhe një prej rasteve ka qenë edhe ajo dhe shumë e shumë raste të shkollave tjera.

Fatmir Iska, drejtor i Drejtorisë për kadastër, gjeodezi dhe pronë – përgjigje në pyetjen e z.Xhemali Haxhimustafa, ish prona ku është vendosur tabela “trualli në shitje” Deponia e mbeturinave, rruga për në Drenoc. Deri në vitin 2007 ajo ka qenë pronë e Komunës dhe në këtë vit sipas aktgjykimit të Gjykatës Komonale në Rahovec lënda nr. 166/2007 këtë pronë në sipërfaqe prej 48 ari e ka fituar Mahmut Hondozi dhe në vitin 2008 më 11 shkurt është bërë shitblerja ndërmjet Mahmut Hondozit dhe Destan Berishës, ndërsa deri në këtë kohë kjo pronë figuron në emër të Destan Berisha nga Xërxa.

Afrim Limani, drejtor i Drejtorisë për financa dhe buxhet – në lidhje me pyetjen për pikën grumbulluese për pemë dhe perime në Xërxe se a është dhënë donacioni i Komisionit evropian Përgjigje: Pika grumbulluese për pemë dhe perime është një grand i fituar nga Komisioni evropian vlera e të cilit është 334.000 € me tre partnerë, dy OJQ dhe Komuna e Rahovecit e cila është bartëse dhe menaxhuese e projektit konkretisht Drejtoria për financa dhe buxhet. Projekti është në fazën e implementimit dhe punët janë duke shkuar sipas dinamikës së paraparë. Projektin do ta kisha ndarë në 3 faza: faza e parë ka qenë trajnimi i fermerëve për kultivimin e pemëve dhe perimeve ndërsa faza e dytë ka të bëjë me meremetimin e objektit ku janë paraparë instalimi i energjisë elektrike, njejt sanitare, uji, ndërtimi i disa zyrave etj. do të thotë faza e dytë është në përfundim. Faza e tretë është blerja e pajisjeve e cila kap një kosto shumë të lartë, tenderi është shpallur dhe është publik. Ky tender ka të bëjë për blerjen e një pajisje frigorifer. Komuna e cila merr pjesë në kuadër të këtij projekti ka për obligim blerjen e një kamioni frigorifer dhe jemi duke e përgatitë tenderin për të bërë publik.

Nahit Elshani – pyetja ka qenë a ka pasur Komuna dijeni për këto dy shoqata apo Komisioni evropian.. Ata e kanë shfrytëzuar pronën komunale pa qira e që është edhe më e keqe e kanë dhënë me qira dhe kur nuk i kanë ofruar raport financiar Komunës. Për atë po them është shqetësimi im kush i ka ofruar ato dy shoqata dhe meqë Komuna duhet të blejë edhe kamion, duhet të dëgjohet edhe fjala e Komunës.

Afrim Limani – na jemi bartës apo trashëgues të këtij projekti. Komisioni evropian i ka disa rregulla strikte të cilave duhet t’i përmbahemi ,do të thotë Komuna nuk ka të drejtë të aplikoj e vetme, mirëpo qëllimi është se Komisioni evropian lejon OJQ-të të cilat në program të vetë kanë gjenerim të të ardhurave dhe gjithsesi si garantues edhe Komuna dhe kjo është arsye pse janë këto dy OJQ.

Smajl Latifi – pajtohem me Afrimin se projekti është i trashëguar dhe jam i informuar se Komuna është partner dhe merr pjesë në projekt me 40.000 €. Ne e kemi trashëguar këtë projekt dhe në vend të ish drejtorit Hamëz Rama vetëm e kemi bërë bartjen dhe përgjegjësinë e ka marr drejtori i ri Afrim Limani, pra ai ka qenë bartës dhe menaxhues nga komuna ndërsa implementues janë OJQ-të.

Nahit Elshani – Komuna nuk merr pjesë me 40.000 € po Komuna ka edhe pronën që ja ka dhënë në shfrytëzim pa qira dhe besoj që është pa kompensim dhe është kërkesë e imja që në të ardhmen që OJQ-të që afarojnë aty duhet t’i raportojnë Komunës e jo të punojnë vetëm për interesin e vet e të mos qajnë kokën për bujkun, kështu ka ndodhur në të kaluarën, unë kam qenë i anëtarësuar në atë Shoqatë, kinse për të marr më lirë preparate por ato i kanë pasur më shtrenjtë, do të thotë ato shoqata duhet të jenë nën kontroll të Kuvendit komunal.

Smajl Latifi – Kuvendi komunal e ka dhënë pronën dhe garanton me 40.000 €, procesi është duke shkuar mbarë tani për tani dhe ne shpresojmë që do të kemi një raport të cilin do ta keni edhe ju sepse do të vihet si pikë e veçantë e rendit të ditës në një prej seancave të ardhshme dhe Afrim Limani do të ketë të gatshëm edhe raportin ose informacionin nga OJQ-të.

Xhemali Haxhimustafa –Komuna merr pjesë me 40.000 € me participim dhe e vërtetë është që projekti është i trashëguar, Komuna është implementues kryesor për arsye se ajo ka konkurruar për këtë projekt, pastaj Komunës i jepet kusht që pas veti për implementim t’i merr shoqatat ndërsa në këtë rast nuk janë shoqatat implementues kryesor. Duhet patjetër të ekzistoj Memorandumi mbi shfrytëzimin e mjeteve që kanë shfrytëzuar dhe kushtet që parashihen, përndryshe Komuna jep 40.000 €, jep edhe pronë për ndërtim, atëherë është automatikisht mbikëqyrës dhe implementues kryesor ndërsa shoqatat janë satelitët të cilët ndihmojnë.

Afrim Limani – Shoqata “Anadrinia” është tërësi e vetme që nuk ka asgjë të përbashkët me pikën grumbulluese dhe është e stacionuar te depot e Matrexit dhe ajo vepron veç 10 vite dhe është problemi i saj se si ka bërë marrëveshje me Mustaf Gashin i cili i ka depot e Matrexit, kanë bërë marrëveshje interne, ndërsa sa i përket pikës grumbulluese është e vërtetë se këto dy OJQ “Anadrinia” dhe SHL Kosova janë bashkë menaxhuese, partnerë të barabartë me Komunën. Implementuese është Komuna së bashku me dy OJQ.

2.1.Pyetjet e këshilltarëve për seancën e ardhshme:

- **Feim Fetoshi** –ka disa kontrata të pronës së Komunës me subjektet tjera të dhëna me qira. Sa kontrata ka të tilla, në çfarë gjendje është realizimi i këtyre kontratave me theks të veçantë në plotësimin e vendeve të punës sipas kontratës?

- **Nahit Elshani** – ky Kuvend ka marr një vendim për dhënie në shfrytëzim të ish objektit të DKA-së për nevojat e partive politike , kemi ndarë 10.000 € të mjeteve vetanake për renovimin e atij objekti, pyetja ime është ku ka ngelë kjo çështje. Nuk më jeni përgjigjur deri sot po kërkoj përgjigje : që Kuvendi komunal respektivisht Qeveria komunale të bëjë evidentimin e të gjitha pronave të cilat janë tjetërsuar nga viti 1990.

Smajl Latifi – për meremetimin e objektit të partive politike është shpall tenderi në bazë të rekomandimeve të inxhinierëve tanë sepse objekti është shumë i vjetër dhe duhet të bëhet meremetimi. Në qoftë se Kuvendi i komunës del me një vendim të qartë që me i rishiku të gjitha ato lëndë, përvetësime të paligjshme dhe tjetërsime të pronave të pronave komunale nga viti 1990 e kënde, ne jemi gati të shkojmë deri në Kuvendin e Kosovës sepse për këtë çështje vendim duhet të merr Kuvendi i Kosovës, ne jemi të interesuar me i rishikuar të gjitha lëndë, ndërsa sa i takon Gjykatës komunale fatkeqësisht ne kemi një evidencë dhe nuk është problem me ditë ku, sa dhe kur është keqtrajtuar, është përvetësuar, është tjetërsuar prona e Kuvendit Komunal. Jemi të interesuar për rishikim dhe unë nuk besoj që nuk jam përgjigj, por Kuvendi duhet të na obligojë.

Kryesuesi – këtë çështje do të vejmë në rend të ditës të Komitetit.

- **Rexhep Oruçi** – kam dy pyetje:

1. Furnizimi i qytetit me ujë të pijes sepse që nga 1 shkurt e këtij 1/3 e qytetit nuk furnizohet me ujë.
2. Shembja e një pjese të rrugës te varrezat ortodokse në Rahovec. Është një mur i ndërtuar më herët dhe nuk siguron rrugën anësore të kubëzuar dhe gradualisht çdo vërshim është duke e mbartë rrugën anësore e kubëzuar para 3-4 vite dhe nëse vazhdon ky trend rrezikohen 7-8 shtëpi të lagjes së Shalajve.

Smajl Latifi - Disa herë po takohemi me përfaqësues të “Radoniqit”. Deri në vitin 2006 Kuvendi komunal ka pasur përfaqësues të tyre në Bord të kompanisë

Tani, as Kuvendi komunal i yni e as Kuvendi i Gjakovës që lidhen me “Radoniqin” nuk kanë përfaqësues. Është e drejtë e rezervuar e Qeverisë së Kosovës përkatësisht e drejtë e MEF-it. Ne po përpiqemi por ata po ankohen se me pagesa jemi shumë keq jo vetëm në qytet por në përgjithësi sa që unë jam detyruar që si kryetar i Komunës që të lëshojnë ujin e pijes në vendbanimet e ndryshme por as Qeveria nuk është duke ndihmuar asgjë. Ne kemi ftuar tani drejtorin gjeneral të “Radoniqit” z.Albert Zajmin që të vijë në komunën tonë për të trajtuar edhe disa çështje që lidhen me sisteme ilegale si me sistemin e ujitjes, sepse këta po ankohen që keni zhvilluar projekte pa dijeninë tonë, pa pjesëmarrjen tonë si HS. Ne do t’i legalizojmë disa projekte të ujësjellësve dhe të sistemit të ujitjes në mënyrë që tani e tutje të kemi një qartësi dhe të kemi mundësi me pas një kooperim pak më të suksesshëm. Sa i

përket reduktimeve ne do të përpiqemi që sivjet së paku të përmirësojmë gjendjen e furnizimit me ujë në qytetit por edhe kudo që kemi mundësi.

- Rustem Thaçi – do të përsëris pyetjen e Elhamiut në lidhje me kanalin e ujitjes Xërxe-Bellacërkë. Ai kanal është në kuadër të projektit të Ministrisë së bujqësisë që është dhënë së bashku me ujin e pijes, mirëpo tani ka ngecë thuaj se në gjysmë të rrugës dhe është hala ma keq se ka qenë gjendja për arsye se pjesë që kanë mbetur afër nuk po munden me akumuluar ujin që bjen. Tani po kërcënohemi prej ujërave atmosferike dhe në këtë nuk ka ndodh që në mes të Xërxës dhe Bellacërkës të përmyten arat me ujë. Kërkoj që të thirret punë kryesi dhe të shikohet meqë e di se ka probleme pronësore-juridike sepse ka devijuar aty ku është trasa e kanalit dhe këto mund të rregullohen, prandaj Drejtoria e cila merret me këtë problematikë të thërret punë kryesin që është Firma “Xërxa” dhe të bisedoj me të, sepse ai i ka prek në esencë pengesat dhe problemet e kësaj natyre dhe të zgjidhet ky problem.

- Sinan Ejupi – nuk e di cila drejtori merret me mirëmbajtjen e ambientit në përgjithësi, jo te pastrimi ndoshta merret edhe Ndërmarrja “Ambienti”, është problem i vogël por mund të del problem që mund të marr jetë, është te rrethi në dalje nga Rahoveci. Është rrit bari aty dhe shumica e njerëzve që nuk janë banorë të këtushëm nuk shkojnë në rreth po dalin direkt sepse nuk shihet fare dhe është shumë e rrezikshme.

- Fatmir Kadiri – dihet që Fabrika e OLT-it ka prodhuar vegla bujqësore dhe ka qenë fabrikë kompakte, dëshiroj që të bëhet evidentimi i pajisjeve themelore dhe nëse ka diçka të na njoftoni me informatë. Nëse ka diçka të mos lihen ato aty kot por të jepen në shfrytëzim apo të shiten nëpërmjet tenderit apo ankandit.

- Lirih Berisha – te ura që del për Drenoc ka filluar shembja e dheut dhe gati që njërin anë e ka zënë dheu. Para një apo dy vite kanë qenë 4 punëtorë si mirëmbajtës të rrugëve dhe administrata e kaluar herë ua ka ndërruar vendet e punës dhe në fund i ka lënë pa punë. A ka mundësi që të dëliret ai dhe kërkesa tjetër është se ka filluar qarja e asfaltit dhe me shpenzime shumë të vogla komuna mund të intervenoj me qëllim të përmirësimit të kësaj rruge.

Smajl Latifi – sa i përket rrethit sot do të dërgojmë një punëtor për të kositur atë bari ndërsa sa i përket asfaltit do të shikojmë pas rishikimit të buxhetit apo ndonjë firmë që ka fituar projekt për asfaltim të intervenojë në përmirësimin e rrugës për Drenoc. Lidhur me 4 punëtorë ata për çdo ditë vijnë herë në Drejtorinë e urbanizmit, herë në Drejtorinë e shërbimeve publike dhe me plotë të drejtë vijnë sepse për një vit askush nuk i ka paguar. Ju kanë thënë që punoni dhe bëjmë një zgjidhje, por nuk figuron dokumentacioni që janë paguar. Janë larguar prej listës së pagave dhe tani ne po mundohemi me gjet një zgjidhje për këta 4 punëtorë qoftë me i pranua si punëtor sezonal apo me ndonjë projekt tjetër, për mos me i lënë pa punë.

- Avdullah Kryeziu – propozoj që për mbledhjet e ardhshme për pyetjet të cilat i bëjmë ne është mirë që drejtorët të përgjigjen me shkrim dhe kur e marrim materialin ne do t’i shohim përgjigjet e drejtorëve dhe nuk ka nevojë që të humbim kaq kohë. Nëse jemi të kënaqur me përgjigjet e drejtorëve mirë e nëse nuk jemi të kënaqur ne do të bëjmë vërejtje këtu. Do të bëjë një pyetje dhe përgjigjen kërkoj për seancën e radhës. Unë jam anëtar i Bordit mbikëqyrës në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ujin e ujitjes Radoniqi-Dukagjini. Unë kam bërë në seancën e kaluar një pyetje të tillë, mirëpo askush sot nuk më është përgjigjur rreth kyçe ilegale në sistemin e ujit të ujitjes në fshatin Celinë gjegjësisht në Krushe që është bërë një kyçe ilegale. Kam informata me shkrim edhe prej Kompanisë po edhe të inspektionit që ka dal në vendin e ngjarjes. Kërkoj përgjigje me shkrim, që të mos bëhen kyçe ilegale. Nëse ne thirremi që jemi institucion me bë menaxhimin atëherë bëjmë keqpërdorim dhe nuk di çka do të bëhet edhe për ujë të pijes edhe për ujë të ujitjes.

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba.

Kryesuesi – kjo Rregullore ka kaluar në Komitet për politikë dhe financa, delegatët kanë dhënë propozimet e veta të cilat janë bartur si propozim i KPF në tabelë të veçantë. Pas aprovimit do të vendoset edhe një kolon e cila do të jetë vendimi i Kuvendit. Për këtë Rregullore në bazë të Ligjit ne kemi mbajtur edhe një debat me qytetarë në të cilin ka marr pjesë një numër modest i qytetarëve dhe kanë dhënë vërejtjet e veta. Po ashtu kanë marr pjesë përfaqësues të Shoqatës së biznesit dhe përfaqësuesit e Sindikatës së pensionistëve të cilët kanë dhënë propozimet të cilat janë vendos në kolonën e fundit.

Musa Cena – drejtor i Drejtorisë për ekonomi dhe zhvillim - duke u bazuar në ndryshimet e ligjeve, rregulloreve të punës nga niveli qendror deri te ai lokal për shkak të nxjerrjes së udhëzimeve administrative të cilat i obligojnë pushtetet komunale që ato t'i jetësojnë në praktikë dhe duke i parë disa kontradikta të vogla me Ligjin iu kemi qasur ndryshimet të kësaj Rregulloreje duke dhënë propozimet dhe arsyet e këtyre tarifave të reja. Në këtë Rregullore kanë punuar ekspertët e lëmive të buxhetit dhe të financave, urbanistë dhe i gjithë stafi qeverisës i Komunës duke mos anashkaluar asnjë moment interesin e buxhetit duke baltur vlerat aktuale dmth. të planifikimit që kemi pasur në mënyrë që komuna me muajt me i krye detyrat dhe përgjegjësitë që i ka e të cilat zbërthehen me anë të buxhetit. Në këtë Rregullore janë bërë disa lehtësira për popullatën kryesisht në sferën e shërbimeve në dhënien e dokumentacioneve. Të gjitha këto zvogëlimet buxhetore që janë paraparë në këto lehtësira, kemi shkruar në rritje të tarifave në sferën ekonomike, më saktësisht në sferën e shërbimeve që japin operatorë të ndryshëm në Komunën e Rahovecit, si që janë bankat dhe shoqëritë siguruese etj. Me një fjalë është ruajt baraspesha dhe vlera e përgjithshme buxhetore.

Rrustem Thaqi – kam një vërejtje te neni 5 nën 1 ku është taksa për rregullimin e tokës ndërtimore ku shkruan “ndërtimi i objekteve individuale dhe banesore” ku vlera është 50 cent për m2 që është shumë e lartë dhe propozoj që të zbritet në 25 cent. Këtë propozim po e bëjë që qytetarët tanë të mos i heqim prej sistemit por të jemi joshës për t'i futur në sistem.

Burim Krasniqi – vërejtja ime është se të gjitha tarifat janë të barabarta pa marr parasysh territorin se ku zhvillohet veprimtaria. Nuk është e njëjtë një taksë komunale të paguhet për një biznes që operon në qytetin e Rahovecit ose në fshatra që janë me frekuentim pak më të madh në dallim prej një që operon në Sapniq ose Zatriq apo zonë më të thellë dhe konsideroj që do të ishte mirë të jetë një koeficient. Te faqja 6 neni 8 pika 3 – dhënia me qira e hapësirë së madhe publike 0.10 € për m2. Për çfarë periudhe kohore është kjo qira. I njëjti problem edhe është në pikën 4b nuk është e shkruar prapë. Te neni 9 pika 1 – dhënia me qira e objekteve nuk është e shkruar për sa kohë. Faqe 5 neni 6 pika 7 – taksa për ekspozimin e mallrave para lokaleve afariste, për çfarë mallra ka të bëjë. A lejohet që mallra ushqimore të ekspozohen para objekteve afariste. Taksa te Drejtoria e shërbimeve publike për dëmtimin e asfaltit, a mbetet te Drejtoria e shërbimeve publike apo Drejtoria e urbanizmt sepse ajo ka të bëjë me rrugët. Kërkesa e pensionistëve duhet më qartë shkruhet me pikat që kanë të bëjnë direkt me Shoqatën e pensionistëve e jo me ato pika që nuk ka të bëjë fare me Shoqatën e pensionistëve ose me pensionistin si individ.

Musa Cena – në fund të tabelës 22,jepen shpjegime se në secilën zonë tatimore janë të ndara prej 1-3.

Përparim Krasniqi – me Statutin e Komunës kompetencat e investimeve kapitale i merr Drejtoria për shërbime publike komunale, për hapësirën publike dhe gërmimet që bëhen.

Salih Hoti – këto tarifa caktohen për çdo vit dhe është normale të bëhen modifikime të ndryshme. Nuk shoh në rregullore se në bazë të cila kriterëve është bazuar tarifa për shkak se bazimi në kriterë është diçka që ndikon drejtpërdrejt edhe në sasinë e buxhetit komunal. Disa zëra tarifar janë për herë të parë të aplikuar e që konsideroj se është zgjeruar baza tatimore dhe për disa tarifa ka pasur propozime që të hiqen prej listës ekzistuese. Është e natyrshme që kur hartohet një tarifë nëse përcaktohen kriterë të shëndosha atëherë është më lehtë të dihet se sa do të jenë të hyra vetanake të Komunës. Ajo çka është me interes është që në bazë tarifave që keni bërë zvogëlim të taksave komunale sa do të humb komuna nga ky zvogëlim, sa mjete buxhetore do të reflektohen drejtpërdrejt. Në ato tarifa që ka rritje prej tarifës ekzistuese sa do të jetë përfitimi i Komunës duhet pasqyruar përqindjen e përafërt me qëllim që ne të dimë se mos e kemi dëmtuar buxhetin e Komunës apo kemi ndikuar që ai të rritet për këtë vit. Ajo çka është problematike ë të ardhmen është përcaktimi i firmave në këto kategori të tarifave. Çfarë kriterë do të përdorni nëse një kompani e vlerësoni po supozojmë një gurëthyes me një kompani prodhuese. Unë pashë disa zëra që ishin më të rënduar te një gurëthyes se sa një ndërmarrje prodhuese dhe nëse është kështu mendoj që duhet me qenë më objektiv sepse nuk mund të jenë të barabartë. Në faqen 8 tabela e parë – ndërrimi i përhershëm ose ndërrimi i përkohshëm dhe i keni përcaktuar vlerat 0,5 € për m2. Kjo vlerë ose mund të jetë e përkohshme ose e përhershme, nuk mund të jetë për të dyja dhe nëse është për dyja nuk duhet të jetë e përhershme apo e përkohshme.

Musa Cena – tarifat bujqësore janë të propozuara nga niveli qendror dhe ne i zbatojmë ashtu si na kanë dërguar.

Salih Hoti – nëse janë të përcaktuara nga niveli qendror është dashur që të ceket këtu dhe ne të mos merremi me këtë. Disa tarifa ke nevojë që të qartësohen më tepër sepse janë shumë kuptimesh si në faqen 9 – kërkesa për shikimin e kafshëve të trasha tarifa vjetore me rastin e therjes. Shtrohet pyetja për kë bëhet fjalë këtu, a ka të bëjë këtu për biznese që ushtrojnë këtë veprimtari apo edhe për familje. Përcaktimi është bërë në baza vjetore në shumë prej 300 € por më e arsyeshme kishte me qenë të shkohet sa herë ka nevojë të bëjë therje dhe atëherë të përcaktohet tarifa sepse në bazë vjetore është e dëmshme. Propozimi i komitetit mendoj se duhet të kaloj edhe në Kuvend.

Musa Cena – për shikimin e kafshëve me rastin e therjes ka të bëjë vetëm me biznese.

Florije Boshnjaku, drejtor e Drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale – sa i përket Drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale kam kërkuar nga KPF që të sqaroj disa çështje me Ligj dhe udhëzime administrative kështu që në Kuvend të dilet më qartë. Neni 17 në Drejtorinë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale kjo Drejtori për këtë vit ka propozuar tri lloj taksa të cilat realizohen nga vërtetimet. Vërtetimi për nxënës dhe student për shtetet e jashtme, Vërtetime për gjendjen shëndetësore për punëtorët në shtetet e jashtme dhe vërtetimet e ngjashme që nuk ceken nga pika 1 dhe 2. Arsyetimi është ky: lëshohen vërtetimet dhe to taksa shkojnë në Drejtori të administratës i disa në shëndetësi. Propozimi im është që pasi i lëshojmë ne këto vërtetime të kalojnë në Drejtorinë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale dhe gjatë auditimit të mos kemi problem.

Taksat tjera të caktuara në nenin 17.1 janë të rregulluara me çmimoret të cilat i sjell Ministria e Shëndetësisë. Po të njëjtin nen pika 21 ku shkruan çdo pacient që i ofrohen shërbime shëndetësore me urgjencë është gabim teknik nga ora 20 deri në 8 të mëngjesit duhet të paguajnë nga një Euro. Ish drejtori i QKMF që kanë qenë më herët ka marrë një vendim që çdo qytetar pa e liru asnjë kategori të paguaj nga 1 Euro kush shkon në urgjencë. Nëse ju pajtoheni që të hyjë kjo taksë këtu në rregull e nëse ju atëherë unë duhet të anulohet atë vendim dhe të mos paguhet kjo taksë. Sa i përket kërkesës së pensionistëve të cilët kanë kërkuar nga participimi në shëndetësi ata janë të liru.

Esad Haxhijaha – është normale që kohë pas kohe çështja e shumëve taksave të shqyrtohet dhe në bazë të bindjeve dhe rrjedhja e cila ka qenë të krijohet mundësia e ndërrimeve qoftë të shtohen taksa apo të ulen. Në këtë propozim po vërehet një numër mjaft i madh i taksave dhe tarifave të cilat më parë nuk kanë qenë që konsideroj se nuk është ashtu dhe janë bërë propozime, qëndron propozimi i ri dhe propozimi i KPF ku kryesisht janë identike. Të njëjtat janë edhe kategoritë të cilat kanë ekzistuar propozimi i mëparshëm dhe ai i cili është realizuar deri më tani, propozimi i ri dhe ai i Komitetit. Propozimet e reja janë të larta. Kryetari gjatë fushatës zgjedhore i ka premtuar qytetarëve se di ti zbret taksat e që këtu nuk po vërehet dhe është mirë me iu përmbajt atyre premtimeve. Kam vërejtje në faqen 8 neni 9 pika 10.2 ku flitet për taksat për dhënien me qira të tokës bujqësore. Këtu është paraparë 1 € për m². Nëse marrim një sipërfaqe prej 10 ari e cila ka 1000 m² dhe nëse për 1m² paguhet taksa në qira del se këto 10 ari duhet të paguhet 1000 €, ndërsa kjo sipërfaqe nuk mund të prodhojë 1000 € çfarëdo prodhimi që të jetë. Tokat e tilla jepen me qira kësaj 0,60 cent për 1 ari dhe nëse është 10 ari atëherë bënë 6 € ndërsa unë propozoj që të jetë 0,10 cent për 1 ari në kategorinë e parë, 0,7 cent kategoria e dytë, 0,5 centë kategoria e tretë dhe do të jetë 3,5 cent për 1m². Në faqen 12 – dhënia e dëshmimeve nga bazat e të dhënave kadastrale tekstuale apo grafike sipas kërkesës së palëve deri tani ka qenë një praktikë e përgjithshme çfarëdo dëshmie që merrej paguhej një taksë prej 1 €, tani është bërë një propozim i ri i cili sipas meje është i tepërt, psh. Dhënia e një vërtetimi 2 €, certifikata mbi pronën 4 €, kopja e planit për një parcelë 3 €, historia e një parcele 15 € që është shumë e tepërt dhe propozoj që të jetë ashtu si ka qenë deri më tani 1 € nën një, 2 € nën dy, 1,5 € nën tre, 0,50 cent nën katër dhe 5 € nën pesë. Në faqen 19 – te Drejtoria e KSR nën 8 – anëtarësimi në bibliotekë për leximin e librave për një vit 2,5 €. Ne po bëjmë angazhime dhe ndikime që të na anëtarësohen nxënësit falas dhe nuk po anëtarësohen e këtu dikush tani e sheh të anëtarësimi të jetë 2,5 €. Në faqen 22 – shërbime për shkollimin me korrespondencë dhe çerdhe fëmijërore. Në komunën tonë nuk ka shkollim me korrespondencë as në shkollë fillore e as të mesme ndërsa çështja e kompensimit të prindërve për qëndrimin e fëmijëve në Çerdhe të fëmijëve është në kompetencë të organeve qendrore. Nëse nuk kemi shkollim me korrespondencë atëherë çfarë nevojë është të parashohim taksa. Rreth kërkesës së pensionistëve për lirim nga taksa edhe më parë është praktikuar që përveç familjeve të dëshmorëve dhe kategorive tjera, të jenë të liru edhe pensionistët sepse ata janë në kategoritë më të rrezikuara.

Jeton Kryeziu – kam paqartësi tek Drejtoria për shërbime publike dhe emergjencë në faqen 5 te pika 7 – për ekspozimin e mallrave para lokaleve afariste, vendosja e tavolinave para lokaleve hoteliere afariste në sipërfaqe paguhet në muaj 2,5 €. A ka të bëjë vetëm për subjektet afariste që e shfrytëzojnë pronën shoqërore apo edhe për ato ndërmarrje të cilët e shfrytëzojnë edhe pronën private?

Musa Cena – nuk ka të bëjë këtu se në cilën cilësi është prona, a është e Komunes apo private.

Jeton Kryeziu – në Drejtorin për ekonomi dhe zhvillim, aktvendimi për vazhdimin e orarit të punës në hotel, restorant dhe motele për një muaj vetëm për dasma dhe ahengje 800 €. Gjatë këtyre dy viteve një taksë të tillë bizneset nuk kanë pasur dhe me këtë shumë bizneset po ngarkohen sepse kanë edhe taksë vjetore 225 € dhe nëse aplikohen këto taksa jam i sigurt që disa biznese do të mbyllen, prandaj propozoj që shumat prej 800 të jetë 300 €.

Musa Cena – orari i punës është prej 07 – 24 dhe vazhdimi i orarit të punës lejohet prej 00,01 deri në orën 00,03 dhe çmimi për një orë është 10 € ndërsa ne kemi propozuar që për shtesë të shkohet vetëm 30 €. Për një muaj është 600 € mirëpo Komiteti për politikë dhe financa ka propozuar që kjo taksë të mbetet ashtu siç ka qenë më parë 800 €.

Avdullah Kryeziu – jam i vetëdijshëm që komunat e Kosovës sipas LVL i kanë edhe kompetencat e bartura prej pushtetit qendror, për atë arsye ka ndryshime në këto taksa dhe tarifa, mirëpo ka edhe gabime gjatë përpilimit të taksave dhe tarifave komunale. Te Drejtoria për shërbime publike komunale dhe emergjencë ku është vlera në m3, në faqen 4 dhe 5 – për ekspozimin e mallrave para lokaleve afariste dhe vendosja e tavolinave para lokaleve hoteliere afariste në sipërfaqen e hapur publike paguhet në muaj 2.5 m3 nuk duhet me qenë por duhet të jetë 2.5 m2 dhe të gjitha këto duhet të shndërrohen në m2. Te taksat për gërmimin dhe dëmtimin e rrugëve me asfalt, mirëpo gjithmonë është problem se kur gërmohet asfalti pala pagan taksë, kush e kthen atë sipërfaqe në gjendjen e mëparshme, Komuna apo ai që e gërmon? Te taksa për dhënie me qira të tokës bujqësore vlera duhet me qenë për 1 ari e jo për 1 m2, prandaj propozoj që të kthehet në ari siç ka qenë më përpara ndërsa te kategoria e tokës shndërrimi i përhershëm dhe i përkohshëm që përmendi Salih më herët tokat e kategorisë I-IV janë të sanksionuara me ligj.

Kryesuesi – a pajtoheni që me këto vërejtjet që i dhatë të cilat do të merren parasysh që Rregulloren të vejmë në votim. Pas hedhjes në votim kryesuesi konstaton se **aprovet Rregullorja për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba.**

4. Shqyrtimi i kërkesës së KRM “Eko-regjioni” Prizren – Njësia në Rahovec.

Kryesuesi – “Ekoregjioni” Njësia në Rahovec kërkon që për shërbimet që kryen qytetit të Rahovecit kërkojnë kushtëzim në disa pjesë të shërbimeve që i kryen Komuna e Rahovecit sidomos në regjistrimin e automjeteve, vazhdimin e lejeve të punës për biznes, lejet ndërtimore, hipotekat dhe dokumentacione tjera kadastrale. Në çfarë gjendje jemi qytetarët shumë pak po paguajnë shërbimet sidomos kompanitë publike siç është për ujë, mbeturina ose të tjera, prandaj është e arsyeshme që edhe ne si Kuvendi i komunës të marrim masa lidhur me këtë çështje sepse për një kohë shumë të shkurtër mund të krijohen mbeturina shumë të mëdha sa që do të paraqet edhe problem për zhvillimin e komunikacionit dhe të njerëzve në qytet.

Xhemali Haxhimustafa - Njësia e Rahovecit e cila ka veprimtarinë kryesore grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave të cilat i deponon në deponime regjionale të Landovicës e cila është larg 22 km, është në një situatë shumë të vështirë të qëndrueshmërisë financiare për arsye se shkallën e inkasimit e ka tepër të ulët, fatkeqësisht për hyrë të kësaj shkalle të ulët të inkasimit kjo Njësi nuk ka mundur të zgjerohet edhe në zonat rurale ku infrastruktura rrugore jep një mundësi për të kryer shërbimet si në Fortesë, Sopniq, Xerxe, Celinë, Krushe e shumë fshatra tjera deri në Krmaovik, mirëpo pikërisht kjo është. Akcionet e kësaj njësie janë të Komunes. Njësia kërkon meqenëse nuk ka mundësi tjetër të inkasimit përveç nga vullneti i mirë të cilët donë të paguajnë, kërkon në një farë mënyre që organet komunale t’i japin mbështetje me një kushtëzim të vogël qytetarëve të cilëve u kryen shërbime, në një mënyrë që të argumentojnë atë se janë duke paguar, normal edhe biznesit. Nuk ka të bëjë me regjistrimin direkt sepse nuk kemi të drejtë t’i përziemi MPB por është çështja tek vërtetimet për taksat komunale. Kur jepet vërtetimi i taksës komunale kërkohet në një farë mënyre edhe argumenti se i ke shlyer borxhet ndaj ndërmarrjes komunale për grumbullimin e mbeturinave. Pa atë vërtetim nuk mund të regjistrohet vetura dhe kjo do të jetë ndihmesë shumë e madhe sepse do të ndihmohet shkalla e inkasimit me 70% dhe kjo Njësi do të mbijetojë sepse në gjirin e vetë ka 28 punëtorë, ka një teknikë

e cila lyp përkujdesje. Kjo Njësi paguan mujore 6.5 € për një tonelatë mbeturina që deponon në Landovicë, e cila deponi menaxhohet nga Kompania për menaxhimin e mbeturinave në nivel të Kosovës. Biznesi i Komunës së Rahovecit respektivisht i qytetit të Rahovecit paguan vetëm 45%.

Gani Raba, drejtor i Njësisë në Rahovec – borxhi për biznese është rritë rreth 100.000 € ndërsa në amvisni rreth 400.000 € kështu që borxhi total është 500.000 €, prandaj jemi të detyruar sikur edhe komunat tjera të aplikojmë një vendim të tillë.

Nahit Elshani – në parim pajtohem me këtë kërkesë, mirëpo problemi është se çka nëse edhe kompania tjetër që është private e Krushës së Madhe kërkon një që të tillë. Kompania në fjalë nuk është komunale sepse po të ishte komunale do t'i raportonte Komunës dhe menaxhimi i kësaj kompanie duhet të ndryshohet dhe normal nëse bizneset e Rahovecit kanë 100.000 € ndaj kësaj Kompanie, atëherë nuk është në rregull me menaxhim.

Xhemali Haxhimustafa – asnjë ndërmarrje private në Kosovë nuk ka licencë për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave, të gjithë privatët që punojnë dhe operojnë në të gjitha nivelet e Kosovës janë ndërmarrje të egra të cilat veprojnë pa lejen e askujt. Ato mund të veprojnë sipas Ligjit mbi ndërmarrjet publike dhe Ligjit mbi mbeturina vetëm nën ombrellën e ndërmarrjes së licencuar kur kjo ndërmarrje nuk ka mundësi që t'i mbulojë të gjitha zonat. Kjo ndërmarrje është pronë e aksioneve komunale por sipas Ligjit mbi ndërmarrjet publike është shoqëri aksionare. Në regjionin e Prizrenit 5 komuna kanë aksionet e veta kush më shumë e kush më pak. Sipas rregullave të Zyrës rregullatore kjo Ndërmarrje ka të drejtë të ndërpres shërbimet njerëzve të cilët nuk paguajnë mirëpo çfarë do të jetë efekti i mbrojtjes së ambientit dhe shëndetit publik.

Salih Hoti – nëse merret ky vendim Komunës i shtohet edhe një detyrë më tepër për mbajtjen e evidencave për çështjen e pagesës së mbeturinave dhe kjo do të bëhet sigurisht në mënyrë indirekte nëpërmjet Kompanisë e cila menaxhon me këtë çështje, sa do të jetë korrekte Kompania në evidencat që do t'i mbajë dhe sa do të mund të menaxhohet drejtë ky proces. Nëse një biznes ka 100.000 € obligime ndërsa Kompania vazhdon sërish t'ja merr mbeturina, konsideroj se nuk është e drejtë kjo dhe nuk është e arsyeshme për shkak se në ato raste duhet të veprojë inspekcioni. Propozoj të bëjmë një test për 3 eventualisht 6 muaj dhe të shohim efektet e këtij veprimi dhe nëse edhe atëherë nuk ka sukses atëherë të kërkohej zgjidhje tjetër.

Esad Haxhijaha – është plotësisht e arsyeshme që të aprovohet sepse pastrimi i mbeturinave të amvisërive e mos të flasim të firmave është shërbim i cili nuk bëhet pa pagesë. Nëse paguajmë tatimin në pronë me rastin e regjistrimit të veturës atëherë duhet të bëjmë edhe pagesën për mbeturina dhe duhet të marrim një vendim për periudhën prej një viti e pastaj do të shohim se çfarë janë efekte. Nëse një gjë kërkohej edhe nga Kompania edhe aty duhet t'i dalim në ndihmë sepse nuk mund të shpenzohet uji pa kufi e të mos paguhet.

Avdullah Kryeziu – çka do të bëhet me Ndërmarrjen për furnizimin me ujë, me ujë të ujitjes për fermerët. Marr në aspektin tjetër është cenimi i të drejtave të njeriut, propozoj që të bëhet një kategorizim. Këtu shkruan që janë rreth 320 biznese që kanë borxh dhe këtu duhet të bëhet kategorizimi, nëse bizneset kanë paguar 50% të borxhet te ata duhet të kërkohej taksa mirëpo te ata që nuk kanë paguar ata duhet të kushtëzohen. Të kërkohej tek ata njerëzit që nuk kanë paguar fare ose inkasimin e kanë nën 50%. Këtë formë do të kërkojnë edhe kompanitë tjera si që është për ujin e pijes, ujë të ujitjes dhe për gjëra tjera.

Xhemali Haxhimustafa – kjo është Ndërmarrje e cila nuk ka kurrfarë instrumenti të pagesës dhe jeton vetëm në bazë të vullnetit të mirë të njerëzve të ndershëm. Uji, KEK-u, PTK-ja kanë instrumente të pagesës sepse kanë ekipet e çkyçjes ndërsa kjo ndërmarrje nuk ka këtë mundësi për këtë edhe kërkon mbështetje komunale.

Rasim Fazliu – duhet të marrim parasysh këtë kërkesë të “Ekoregjionit” dhe arsyet janë të shumëfishta e në radhë të parë mbrohet ambienti ekologjik pastaj mbrohet shëndeti i njerëzve të Komunës ku ndikon drejtpërdrejt që të mos vie deri te përhapja e sëmundjeve të ndryshme për rrezikimin e jetës së njerëzve dhe kjo masë do të ndikojë në vetëdijesimin e qytetarëve se për çdo shërbim që kryhet duhet të bëhet edhe pagesa dhe jam për përkrahjen e kësaj Kompanie.

Kryesuesi – për qytetin e Rahovecit që është më i frekuentuar ne nuk mund të lejojmë që mbeturinat të derdhen nëpër rrugët dhe vendet publike. Me gjithë se këtë problem e ka tërë Kosova por deri sa bëhen projekte ose programe që në të ardhmen të funksionojnë ashtu si duhet, mendoj që ashtu si edhe

komunat tjera që kanë marr masa, të vetmen mundësi e përdorin këtë që t'i kushtëzojnë me vërtetime ose leje të ndryshme nga Administrata e Komunës duhet t'i japim shansë dhe të shohim se sa do funksionojë kjo kërkesë dhe afati të jetë së paku për një vit për të zgjidhur këtë problem dhe po e përmbylli debatin për këtë çështje dhe po e vejë në votim.

Smajl Latifi, kryetar i Komunës – ne kemi shqyrtuar dhe analizuar se si të gjejmë mundësinë por është Ligji që nuk na jep mundësi për të krijuar një Kompani komunale që merret ekskluzivisht me këto çështje dhe kjo është në kreu të Kosovës. Kjo kërkesë nuk është shkelje e të drejtave të njeriut sepse është njëri nga modalitetet që borxhlinjtë t'i detyrojmë të bëjnë pagesat për shërbimet cilat i kryhen prandaj ju ftoj që të mbështetni këtë kërkesë sepse kështu po veprohet edhe në komunat tjera. **Nahit Elshani** – Propozoj që Kompania listën e borxhlinjve me emër dhe mbiemër t'i ofroj komunës për shërbimet e kryera dhe mos me pasur nevojë të nxjerr vërtetimin se a ka paguar apo jo borxhin. Kryesuesi ka hedhë në votim propozimin e kërkesës “Ekoregjioni” Njësia në Rahovec dhe ka konstatuar se e njëjta kërkesë me shumicë votash është aprovuar.

5. Zgjedhja e një anëtarit në Komisionin për ndarjen e bursave në vend të Dervish Çadrakut ish drejtorit të Drejtorisë për administratë të përgjithshme.

Zgjedhja e anëtarit të Komisionit për ndarjen e bursave i është lënë në kompetencë kryetarit të Komunës.

6. Informimi i kryesuesit të Kuvendit për vizitën e delegacionit të Komunës së Rahovecit në Turqi në qytete Izmir Ajdin dhe Turgutli. Ku në delegacion ishin: Kujtim Popaj, Hazër Tara, delegatët Rasim Fazliu, Nahit Elshani, Rexhep Oruçi dhe Burim Krasniqi dhe një përfaqësues i fshatit Fortesë. Delegacioni ka qëndruar prej 29.05. deri më 1.06.2011, janë vizituar 3 ndërmarrje të po atij pronari dhe kemi parë nga afër punën dhe teknologjinë. Fabrika ishte ngjitur me qytetin dhe nuk ka tym ose ndotje të ambientit. Është informuar pronari për brengat të cilat i kanë ngritur qytetarët e fshatit Fortesë me peticionin që i janë drejtuar Kuvendit. Në vazhdim nëpërmjet CD-së është treguar teknologjia e cila do të përdoret për Fabrikën e cila do të hapet në Fortesë.

Rrustem Thaçi –propozimi është që të shkohet në Fortesë dhe të bisedohet me lagjen e gashte dhe lagjen që janë më afër fabrikës dhe ata të binden, në qoftë se banorët binden votën e Kuvendit e keni 100%. Ky delegacion dhe anëtarët e Asamblesë nga Fortesa të caktoni një takim dhe këto incizime që keni bërë në Izmir t'i njoftoni edhe ata.

Mbledhja ka përfunduar në ora 16.

K r y e s u e s i
Kujtim Popaj